

L I G J
Nr.8256, datë 19.11.1997

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8227, DATË 30.7.1997 "PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË
PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I
GJERË""**

Në mbështetje të neneve 10, 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"", pas nenit 6 shtohet neni 7 me këtë përmbajtje:

Pas nenit 73 të ligjit shtohet neni 74 me këtë përmbajtje:

"Administratori i subjektit të kontrollit ose i personit të lidhur me të ka të drejtë të vendosë për të mos zbatuar kushtet e parashikuara në ndonjë kontratë apo marrëveshje të lidhur, para datës së caktimit të administratorit, ndërmjet subjektit të kontrollit apo personit të lidhur me të dhe personave të tretë, të pezullojë tërësisht apo pjesërisht ripagimin e ndonjë huaje apo pagimin e një detyrimi.

Drejtimi i veprimtarisë dhe i pasurisë së subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta i kalon administratorit. I gjithë personeli drejtues i subjekteve të kontrollit apo të personave të lidhur me ta nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre për drejtimin e veprimtarisë apo të marrin veprime lidhur me pasuritë e subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të, me përjashtim të rasteve kur një e drejtë e tillë u njihet nga administratori në përputhje me kushtet e përcaktuara prej tij.

Administratori i subjektit të kontrollit, ose i personave të lidhur me të, ushtron të gjithë të drejtat e aksionerit, ortakut, si dhe personelit administrativ të tyre. Ai ka të drejtë:

- a. të realizojë veprimtarinë e subjektit të kontrollit apo të personave të lidhur me të;
- b. të administrojë pasurinë e tyre në mënyrën që ai e konsideron të nevojshme;
- c. të caktojë apo kontrakttojë këshilltarë profesionistë, si dhe agjentë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- d. të ndalojë subjektin e kontrollit apo personin e lidhur me të të marrë hua, ose të mobilizojë mjete monetare nga publiku.

Administratori i subjektit të kontrollit apo i personave të lidhur me të ka të drejtë të shesë a të disponojë në mënyrë ligjore pjesë të veprimtarisë së personave të mësipërm apo pjesë të pasurisë së tyre në kushtet që ai e konsideron të arsyeshme. Në rast se ndonjë pasuri e subjektit të kontrollit apo e personave të lidhur me të është vendosur si masë garancie prej tyre, një gjë e tillë nuk e pengon administratorin të realizojë të gjitha procedurat e shitjes apo të përdorimit të tyre. Përfituesi i masës së sigurimit mund të paguhet nga procedurat e shitjes apo të administrimit të këtyre pasurive me prioritet në krahasim me kreditorët e tjerë, me përjashtim të kostos së administrimit gjatë shitjes apo përdorimit të këtyre pasurive. Përfituesi i masës së sigurisë e fiton këtë të drejtë vetëm nëse administratori mendon se kjo masë për sigurimin e një veprimi është vënë në mënyrë të vlefshme për të siguruar një veprim të pastër ose mbrojtjen e një detyrimi pa mashtrim në favor të përfituesit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit të tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1961, datë 20.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Rexhep Meidani